



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:165998

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05797672

P.nr. 368/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurve 1) B. I. dhe 2) Sh. H., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje “Shpërdorimi i pasurisë së huaj” nga neni 318 par. 5 lidhur me par. 1 dhe 31 të KPRK-së, ndërsa i pandehuri B. I. edhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4314/2023, të datës 20.07.2023, pas përfundimit të seancës së hapur të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 27.05.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Kastriot Berisha, të pandehurve dhe mbrojtësit të pandehurit të parë të caktuar sipas detyrës zyrtare av. S. E., me datë 03.06.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 07.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1. B. I., nga i ati B. dhe nëna S., mbiemri i vajzërisë së nënës R., i lindur më ... në P., me vendbanim në Rr. “J. G.” në P., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën fillore, me profesion agjent i thirrjeve telefonike, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. SH. H., nga i ati F. dhe nëna N., mbiemri i vajzërisë së nënës M., i lindur më ... në P., me vendbanim në Rr. “H. S. B.” në P., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme të Telekomunikacionit, me profesion punëtor fizik në ndërtimtari, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjykuar më parë.

JANË FAJTORE

Sepse:

Të pandehurit Sh. H. dhe B. I.;

I. Me datë 10.06.2023, rreth orës 18:20, në “B. e D.” në P., e dëmtuara S. B., e harron kuletën në të cilën kishte 705 Euro, kartelën bankare dhe dokumentet personale dhe më pas rreth orës 19:00 të të njëjtës datë, i pandehuri Sh. H. i cili ishte me të pandehurin B. I., afrohet dhe e merr kuletën duke vazhduar më tutje pa e paraqitur rastin në polici dhe pasi që largohen i ndajnë të hollat me njëri tjetrin duke e hedhur kuletën në shportë të mbeturinave, ku pas identifikimit të të pandehurve nga kamerat e sigurisë dhe ndalimit nga policia, tek i pandehuri Sh. janë gjetur 397 Euro, 1 dollar dhe një palë vathë, kurse tek i pandehuri B. janë gjetur 302 Euro, dy kartela bankare, letërnjoftimi dhe patentë shoferi personal i të dëmtuarës dhe një thikë.

- me këtë të pandehurit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Shpërdorimi i pasurisë së huaj” nga neni 318 par. 5 lidhur me par. 1 dhe 31 të KPRK-së.

2. I pandehuri B. I.;

II. Me datë 10.06.2023, rreth orës 18:20, në “B. e D.” në P., pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin për armët, në vend publik, ka mbajtur në posedim një mjet të mprehtë – thikë, e cila sipas ligjit për armët cilësohet si armë.

- me këtë ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 21, 31, 39, 42, 43, 46, 47, 48, 49 par. 5, 50, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 367 dhe 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 dhe 2.9 të KPP-së të pandehurit i:

GJ Y K O N

Të pandehurit Sh. H. dhe B. I., për veprën penale si në pikën (I);

I. DËNIM ME KUSHT, ashtu që secilit veç e veç u shqipton Dënim me Gjobë në shumën prej dyqind (200) Euro dhe u vërteton Dënimin me Burgim në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditësh, dënime të cilat nuk do të ekzekutohen nëse në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të pandehurit nuk kryejnë vepra tjera penale.

Të pandehurit B. I., për veprën penale si në pikën (II);

II. DËNIM ME GJOBË në shumën prej njëqind (100) Euro, të cilën detyrohet ta paguajë në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në shumën dhe brenda afatit të përcaktuar si në pikën (II) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, atëherë ky dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

DETYROHEN të pandehurit që në emër të shpenzimeve paushalle secili veç e veç të paguaj shumën prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimin po ashtu secili veç e veç shumën prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

KONFISKOHET ... armë e ftohtë (...), si mjet i kryerjes së veprës penale, e cila është gjetur tek i pandehuri B. I..

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II.nr.4314/2023, të datës 20.07.2023, kundër të pandehurve 1) B. I. dhe 2) Sh. H., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje "Shpërdorimi i pasurisë së huaj" nga neni 318 par. 5 lidhur me par. 1 dhe 31 të KPRK-së, ndërsa i pandehuri B. I. edhe për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 27.05.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi bindet se të pandehurit e kuptojnë aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, të njëjtëve u ofroi mundësinë e deklaramit rreth fajësisë - të pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar apo të deklarohen të pafajshëm.

Të pandehurit secili veç e veç kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar, kanë shprehur keqardhje dhe pendesë të thellë për veprimet të cilat ata i kanë ndërmarrë ditën kritike, kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisin veprime të tilla apo të kryejnë vepra tjera penale, nga gjykata kanë kërkuar që këto rrethana t'i merr parasysht, të njëjtëve tu shqiptoj një sanksion më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se të pandehurit kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimin të fajësisë nga të njëjtët, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit të parë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, pranim i cili është bërë në mënyrë vullnetare pasi që më parë kanë kuptuar pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, gjykatës i ka propozuar që të aprovojë pranimin e fajësisë, ndërsa me rastin e shqiptimit të dënimit, ndaj të pandehurve si rrethanë lehtësuese të merr parasysh faktin se të njëjtit për herë të parë kanë rënë ndesh me ligjin, si dhe faktin se sendet e marra i janë kthyer palës së dëmtuar.

Mbrojtësi i të pandehurit B. I. av. S. E. lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës, andaj gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykatës i propozoi që si rrethana lehtësuese për të pandehurin të merr parasysh pranimin e fajësisë nga i njëjti në të gjitha fazat e procedurës, kërkim faljen dhe pendimin për veprimet e ndërmarra nga ana e tij, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë veprë tjetër penale, të gjitha gjësendet që i janë marrë të dëmtuarës të njëjtat i janë kthyer, nga gjykata ka kërkuar që të njëjtit t'i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga të pandehurit në shqyrtim fillestar, keqardhjen e shprehur dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale, sjelljen korrekte të tyre në gjykatë, rrethanë tjetër me rëndësi për tu potencuar qëndron fakti se e dëmtuara është paraqitur në gjykatë me datë 28.05.2024 dhe ka deklaruar se ndaj të pandehurve nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi për arsye se sipas saj është kompensuar të njëjtën ditë ku edhe është kryer vepra penale, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj mbi bazën e arsyeve dhe rrethanave të sipër theksuara gjykata vlerësoi se dënimin me kusht si dënim alternativ i shqiptuar të pandehurve është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tyre, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 të KPRK-së, i cili konsiston në risocializimin e të pandehurve me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurve seriozisht u tërhiqet vërejtja dhe u bëhet me dije se nëse të njëjti kryejnë vepra tjera penale brenda periudhës së verifikimit të përcaktuar si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të nenit 366 par. 3 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 242 dhe 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.368/23, Datë 07.06.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik SHEQIRI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet kësaj Gjykate.